

VENDIM
Nr.14, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR BRADSAT”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Arben Xhina, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Bradsat”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Bradashesh.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati